

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**

**Pasqyrat Financiare për periudhën nga 31 maj 2018 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2018**

## Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar .....	2
Pasqyra e performancës financiare .....	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto .....	4
Pasqyra e flukseve monetare .....	5
Shënime të pasqyrave financiare.....	6



Ernst & Young Certified Auditors  
Albania Branch  
NIUS: K619110121  
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, kati 6  
1001, Tiranë, Shqipëri

Tel: +35542419575  
ey.com

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Transcom WorldWide Albania sh.p.k

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Transcom WorldWide Albania sh.p.k ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjëstë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Transcom WorldWide Albania sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega Shqipëri


27 janar 2020  
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel  
Auditues Ligjor



	Shënime	31 Dhjetor 2018
<b>Aktivet</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	7	8,498,265
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	8	114,581,984
Shpenzime të shtyra	9	1,286,701
Të arkëtueshme të tjera	10	3,775,453
<b>Totali i aktive afatshkurtra</b>		<b>128,142,403</b>
<b>Aktive afatgjata</b>		
Aktivet afatgjata të trupëzuara	6	25,802,410
Aktive afatgjata jo të trupëzuara	6	275,691
Emri i mirë	3 (j)	100,146,004
<b>Totali i aktive afatgjata</b>		<b>126,224,106</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>254,366,509</b>
<b>Detyrime</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	11	10,734,959
Tatim mbi fitimin	15	9,554,576
Të pagueshme të tjera	12	38,375,344
Hua	13	129,591,000
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>188,255,879</b>
<b>Kapitali neto</b>		
Kapitali i nënshkruar	14	1,271,700
Fitimi i vitit		64,838,930
<b>Totali i kapitalit neto</b>		<b>66,110,630</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit neto</b>		<b>254,366,509</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar nga drejtimi i Transcom Worldwide Albania shpk më 13.01.2020:

  
Gianluca Gemma  
Administrator

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 deri 20.

Pasqyra e performancës financiare	Shënime	Periudha nga 31 maj deri më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shërbimet	17	315,752,417
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>315,752,417</b>
Shpenzime për personelin	18	(207,056,566)
Shpenzime amortizimi	6	(1,787,516)
Shpenzime të tjera operative	19	(28,803,496)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>78,104,839</b>
Shpenzime financiare		(2,288,154)
Fitime nga kursi i këmbimit, neto		576,821
<b>Shpenzime financiare, neto</b>		<b>(1,711,333)</b>
<b>Fitimi përpara tatimit</b>		<b>76,393,506</b>
Tatim mbi fitimin	16	(11,554,576)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>64,838,930</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 deri 20.

## Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet/Hu mbjet e akumuluar	Totali
<b>Gjendja më 31 Maj 2018</b>	-		-
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital	-		-
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	1,271,700		1,271,700
<b>Totali i veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital</b>	<b>1,271,700</b>		<b>1,271,700</b>
Të ardhura gjithëpërfshirëse të vitit	-		-
Fitimi i vitit		64,838,930	64,838,930
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>1,271,700</b>	<b>64,838,930</b>	<b>66,110,630</b>

Pasqyra e ndryshimeve në fondet neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 deri 20.



Transcom WorldWide Albania sh.p.k  
Pasqyra e flukseve monetare për periudhën nga 31 maj 2018 deri më 31 dhjetor 2018

(Shumat në Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2018
Fitimi përpara tatimit mbi fitimin		76,393,506
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	6	1,787,516
		<u>78,181,022</u>
<i>Ndryshime në:</i>		
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	8,10	(118,357,437)
Parapagime	9	(1,286,701)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	11,12	58,664,879
<b>Totali i ndryshimeve</b>		<u>(60,979,259)</u>
Tatim fitim i paguar	16	(11,554,576)
<b>Flukse monetare nga veprimtaria operative</b>		<u>5,647,187</u>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata të trupëzuara	6	(27,865,618)
Emri i mirë	6	(100,146,004)
<b>Flukset monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<u>(128,011,622)</u>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë financuese</b>		
Kapitali aksionar	14	1,271,700
Huamarrje	13	129,591,000
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë financuese</b>		<u>130,862,700</u>
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalent me to		8,498,265
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		-
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor</b>		<u>8,498,265</u>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 dhe 20.



## 1. HYRJE

Transcom Worlwide Albania sh.p.k (në vijim referuar si “Shoqëria”) është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 8 qershor 2018 nën formën juridike shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NIPT L81808502Q.

Shoqëria është themeluar dhe zotërohet nga aksioneri i vetëm, Transcom WorldWide AB e cila ka nënshkruar një kapital fillestar prej 1,271,700 Lekë.

Shoqëria e ushtron aktivitetin në adresën Rr “Taulantia”, Lagjia 1, Durrës. Objekti i aktivitetit së Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve telefonike për të tretë. Numri i punonjësve të Shoqërisë në 31 dhjetor 2018 është 561.

## 2. BAZA E KONTABILITETIT

### a) Deklarata e pajtueshmërisë me parimet kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

### b) Baza e përgatitjes financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

### c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë shqiptare (Lekë), që është dhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

### d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, çmuajje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme për shkak të këtyre çmuajjeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Veçanërisht, informacioni në lidhje me vlerësimet më të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykimet që lidhen me zbatimin e SNRF-së të cilat ndikojnë në shumat të konsiderueshme në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet 4 dhe 21 të pasqyrave financiare.

## 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

### (a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (a) Transaksione në monedhë të huaj (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kursi mesatar 2018	Kursi raportues 2018
ALL / EUR	127.59	123.42

#### (b) Të ardhura

Shoqëria ofron shërbime telefonike për të tretë.

SNRF 15 është zbatuar nga Shoqëria në pasqyrat financiare sic shpjegohet më poshtë:

- Modifikimet e kontratës: Shoqëria nuk ka pasur ndonjë ndryshim të kontratave lidhur me qëllimin e kontratës ose shumën korresponduese të kontratës.
- Detyrimet shtesë të performancës të identifikuara: Në përgjithësi, Shoqëria siguron vetëm një detyrim të veçantë të performancës. Në rastet e dy detyrimeve të veçanta të performancës, shërbimeve të tranzitit dhe shërbimeve të alokimit të kapaciteteve, çmimi i transaksionit për secilën detyrim të veçantë të performancës bazohet në çmimin specifik të shitjes.
- Shuma të ndryshueshme: Çmimi i transaksionit nuk bazohet në shumën e ndryshueshme.
- Komponentë të rëndësishëm të financimit: Shoqëria nuk ka dhe nuk pret që të ketë kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti tejkalon një vit.
- Programet e besnikërisë ndaj klientit: Shoqëria nuk zbaton ndonjë program besnikërie.
- Përcaktimi i kohës së njohjes së të ardhurave (njohja përgjatë kohës ose njohja në një moment të caktuar kohor): Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen, pra në një moment të caktuar kohor.
- Rimbursimet: Shoqëria nuk zbaton rimbursime.
- Kostot shtesë të marrjes së një kontratë: Shoqëria nuk ka kryer ndonjë kosto shtesë për të marrë një kontratë.
- Kostot për të realizuar një kontratë: Shoqëria nuk ka kryer ndonjë kosto për të realizuar një kontratë.
- Paraqitja e aktiveve të kontratës dhe detyrimeve të kontratës: Zbatimi i SNRF 15 nuk kishte ndonjë ndikim në Shoqëri që do të sillte njohjen e ndonjë aktivi apo detyrimi të kontratës.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (c) Përfitimet e punonjësve

##### *Stigurimet shoqërore të detyrueshme*

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të vet dhe të punonjësve në përputhje me legjislacionin lokal për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

#### (d) Të ardhurat dhe shpenzime financiare

Të ardhurat (shpenzimet) financiare neto përbëhen nga shpenzimet e interesit dhe nga fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara nga këmbimet valutore, të cilat raportohen neto në këto pasqyra financiare.

#### (e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi-fitimi njihet në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Një tatim i shyrë njihet deri në atë vlerë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme. Aktivitetet e njohura nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

#### (f) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në baza lineare mbi kohëzgjatjen e qirasë. Zbritjet nga qiraja janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, përgjatë afatit të qiradhënies.

#### (g) Parapagimet

Parapagimet maten me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin priten të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivitetit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivitetit dhe pret nga ky aktiv përfitime ekonomike të ardhshme. Parapagimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një tregues se aktivitetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të merren, vlera e mbartur e parapagimit zhvlerësohet dhe një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (h) Aktivet afatgjata të trupëzuara

##### *Njohja dhe vlerësimi*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

##### *Kostot e zëvendësimit*

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm nëse parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot që rrjedhin nga përdorimi normal i aktiveve afatgjata materiale janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

##### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet në mënyrë që të shpërndahet kosto e aktivitetit e pakësuar me vlerën parashikuar të mbetur të tij duke përdorur metodën lineare mbi jetën e vlerësuar të dobishme. Aktivitetet me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe e jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata të trupëzuara për periudhën ekzistuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

- |                       |        |
|-----------------------|--------|
| • Pajisje zyre        | 5 vjet |
| • Mobilje             | 5 vjet |
| • Pajisje informatike | 7 vjet |

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen çdo datë raportimi dhe korrigjohet nëse është e nevojshme.

#### (i) Aktivet afatgjata jo të trupëzuara

Aktivitetet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria, të cilat përfshijnë programe kompjuterike (software) dhe licensë, janë regjistruar me kosto të pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin (në rastin kur aplikohet). Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata jo të trupëzuara për periudhën ekzistuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

- |            |         |
|------------|---------|
| • Software | 7 vjet  |
| • Licensë  | 10 vjet |

#### (j) Emri i mire

Emri i mirë është krijuar nga transferimi i aktivitetit që Shoqëria ka kryer sipas marrëveshjes së datës 28 qershor 2018. Marrëveshja e transferimit konsiston në transferimin e të gjithë aseteve të shoqërisë së mëparshme Nethex, kontratave të punonjësve edhe disa kontrata me furnitorët, ndër të cilat më e rëndësishmja kontrata e ambjenteve me qira. Vlera e drejte e aktiveve të identifikueshme që rezultoi të ishte vetëm akteve të trupëzuara, në total berbejne Lek 22,242,000. Transferimi i aktivitetit është kryer me një çmim prej 950,000 Euro ose Lek 119,607,000. Emri i mirë është krijuar si diferencë e çmimit të blerjes me aktivitetet, duke shtuar edhe të gjitha shpenzimet ligjore dhe noteriale për arritjen e marrëveshjes së transferimit të aktivitetit. Emri i mire i njohur është Lek 100,146,004.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (k) Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente, të pagueshmet dhe huatë afatshkurtra. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

##### *Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

##### *Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

##### *Të pagueshmet*

Të pagueshmet fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

##### *Huatë afatshkurtra*

Huatë afatshkurtra fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar. Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet e financave diskutohet në politikën kontabël 3 (d).

#### (l) Zhvlerësimi

##### *(i) Aktivët financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar. Humbja nga zhvlerësimi e një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivët financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivët e mbetura financiare janë vlerësuar së bashku në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditimit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në rast se rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me ngjarje që ndodhin pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerat në pasqyrat financiare të Shoqërisë për aktivët jofinanciare, përveç të drejtave tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi, nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin.

Në rast se ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së saj në përdorim dhe vlerës së saj të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme të vlerësuara zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit. Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, aktivitet që nuk mund të testohen në mënyrë individuale janë grupuar së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë kryesisht të pavarura nga hyrjet në mjete monetare të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese të mjeteve monetare", ose "NJGJMM").

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Një humbje nga zhvlerësimi njihet kur vlera e mbartur e një aktivi ose NJGJMM tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NJGJMM janë alokuar për të zvogëluar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grup njësisish) në baza proporcionale. Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi për çdo tregues se humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar, neto nga zhvlerësimi ose amortizimi, nëse nuk ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

#### (l) Provigjonet

Një provigjon njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyre të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një dalje e flukseve të të mirave ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjonet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

#### (k) Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa bazuar në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, në varësi të qasjes, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për njesite ekonomike që zgjedhin të aplikojnë opsionin përjashtimit të përkohshëm, ose kur njesia ekonomike aplikon për here të parë SNRF 9 për njesitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Transferimet e Aktivit të Investuar" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Disa standarde dhe interpretime të reja që janë nxjerre dhe janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ose më vonë, Shoqëria nuk i ka zbatuar në një kohe më të hershme.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (k) Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

**SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).** Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësin merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qera operative ose qera financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17. Prandaj, një qiradhënësi vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera operative ose qera financiare dhe të kontabilizojë këto dy lloje të qirasë ndryshe.

Shoqëria vendosi që do të zbatojë lehtësinë praktike për qirate afatshkurtra.

Ndryshimet që mund të jenë të rëndësishme për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të tij, janë paraqitur më poshtë:

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët të tij - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- KIRFN 23 "Paqartesi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja" (publikuar më 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Përcaktimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

#### 4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave të kontabilitetit

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmerite e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme për rrethanat. Drejtimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Vendimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një ndryshim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:



#### 4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave të kontabilitetit (vazhdim)

**Vlerësimi i modelit të biznesit.** Modeli i biznesit drejton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Shoqëria konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritshmerite për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të përkeqësimit të kredisë konsiderohen konsistente me modelin e biznesit "mbaj për të mbledhur". Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të riskut të kreditimit, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit "mbaj për të mbledhur", me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Shoqëria vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes gjatë 3 viteve të fundit të aktivitetit financiar, përpara 1 janarit 2018. Gjithashtu, shitja e aktiveve financiarë e pritshme vetëm në skenarë të një vështirësie financiare, ose në përgjigje të një ngjarjeje të izoluar që është përtej kontrollit të Shoqërisë, nuk është e përsëritur dhe nuk mund të ketë qenë parashikuar nga Shoqëria, konsiderohen si të rastësishme ndaj objektivit të modelit të biznesit dhe nuk ndikojnë në klasifikimin e aktiveve financiare përkatëse.

Modeli i biznesit "mbaj për të mbledhur dhe shitur" nënkupton që aktivet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një marzhi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato aktive.

Kategoria e mbetur përfshin ato portofole të aktiveve financiare, të cilat menaxhohen me qëllim të realizimit të flukseve monetare kryesisht nëpërmjet shitjes, si p.sh. kur ekziston një model tregtimi. Mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale shpesh është e rastësishme për këtë model biznesi.

Për zbatimin e SNRF 9, Shoqëria identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbaj për të mbledhur", me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk i jepet riskut të çmimit ose vlerës së drejtë;
- Deri tani nuk ka pasur asnjë shitje. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të riskut të kredise, që rezultojnë nga shkeljet e kritereve të brendshme të riskut të kredise. Këto shitje do të ishin në përputhje me një model biznesi "mbaj për të mbledhur". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore.

Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbaj për të mbledhur".

**Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit ("VPPI").** Përcaktimin nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kërkon gjykim.

Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezultojnë nga një transaksion në fushën e SNRF 15, që konsiderohet të jetë principal. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

**Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale.** Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me aktiveve të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të mishëruara në aktive konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe tregtare dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në aktive. Drejtimi vlerëson normat e amortizimit, të cilat reflektojnë jetën e dobishme të mbetura, në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që aktivet të sjellin përfitime për kompaninë. Shoqëria ka konsideruar faktorët kryesorë në vijim: (a) përdorimi i prituri të aktiveve; (b) mirembajtja e pritshme, e cila varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose tregtar që rrjedh nga ndryshimet në kushtet e tregut.

## 5. Menaxhimi i Riskut Financiar

Shoqëria ka ekspozim ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të kompanisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme sasiore përfshihen në këto pasqyra financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Shoqëria, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë.

Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga paratë e gatshme në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huate dhe detyrimet e tjera.

### (i) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë ekziston nëse palët nuk mund të përmbushin detyrimet e tyre të pagesave për të arkëtueshmet.

Shoqëria vlerëson si të kënaqshme cilësinë e kredisë së të arkëtueshmeve që nuk janë as të vonuara as të zhvleresuara. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë të arkëtueshme nga shoqëria mëmë.

	2018
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	118,357,437
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8,498,265
<b>Totali</b>	<b>126,855,702</b>

5. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(ii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare në afat. Qasja e kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe nën rastet e vështirësisë financiare, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

2018	Më pak se 3 muaj	Nga 3 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Llogari të arketueshme	118,357,437	-	-	118,357,437
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	8,498,265	-	-	8,498,265
<b>Total</b>	<b>126,855,702</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>126,855,702</b>
<b>Financial liabilities</b>				
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	49,110,303	-	-	49,110,303
Tatim fitimi i pagueshëm	9,554,576	-	-	9,554,576
<b>Total</b>	<b>58,664,879</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>58,664,879</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018</b>	<b>68,190,823</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>68,190,823</b>

(iii) Rreziku i tregut

Rreziku i normës së interesit

Shoqëria nuk ka instrumente financiare me interes më 31 dhjetor 2018.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Lekë dhe Euro. Rreziku i monedhës menaxhohet përmes përdorimit të parimeve të përputhjes së aktiveve / detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë këmbim të ardhshëm ose transaksione të produkteve të derivativëve të përfshirë më 31 dhjetor 2018.

2018	EUR	ALL	Total
<b>Aktive financiare</b>			
Llogari të arketueshme	114,581,984	-	114,581,984
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	8,186,384	-	8,186,384
<b>Total</b>	<b>122,768,368</b>	<b>-</b>	<b>122,768,368</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	6,885,563	-	6,885,563
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-	-
<b>Total</b>	<b>6,885,563</b>	<b>-</b>	<b>6,885,563</b>
<b>Risku i kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2018</b>	<b>115,882,805</b>	<b>-</b>	<b>115,882,805</b>

6. AKTIVE AFATGJATA TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA

	Programe	Kompjuter	Pajisje informatike server	Rrjet informatik	Rrjet telefonik portabel	Rrjet telefonik	Telefona	Pajisje Zyre	Instalime dhe pajisje	Totali
Më 31 maj 2018										-
Shtesa	293,140	15,282,877	428,106	239,963	32,510	21,953	7,252,911	3,506,763	807,395	27,865,618
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Me 31 dhjetor 2018</b>	<b>293,140</b>	<b>15,282,877</b>	<b>428,106</b>	<b>239,963</b>	<b>32,510</b>	<b>21,953</b>	<b>7,252,911</b>	<b>3,506,763</b>	<b>807,395</b>	<b>27,865,618</b>
Më 31 maj 2018										-
Amortizimi i periudhës	17,449	841,311	37,097	14,284	1,935	1,307	608,453	242,404	23,277	1,787,516
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>17,449</b>	<b>841,311</b>	<b>37,097</b>	<b>14,284</b>	<b>1,935</b>	<b>1,307</b>	<b>608,453</b>	<b>242,404</b>	<b>23,277</b>	<b>1,787,516</b>
Më 31 maj 2018										-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>275,691</b>	<b>14,441,566</b>	<b>391,009</b>	<b>225,679</b>	<b>30,575</b>	<b>20,646</b>	<b>6,644,458</b>	<b>3,264,359</b>	<b>784,118</b>	<b>26,078,102</b>

Transcom Worldwide Albania sh.p.k  
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lekë)

**7. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO**

**31 dhjetor 2018**

Llogaritë rrjedhëse:

Në EUR

8,186,384

Në Lekë

311,880

**Totali**

**8,498,265**

Gjendja e mjeteve monetare në bankë më 31 dhjetor 2018 përbëhet nga llogari rrjedhëse të mbajtura pranë bankës Societe Generale Albania në Shqipëri.

**8. LLOGARI TË ARKËTUSHME TREGTARE TË TJERA**

**31 dhjetor 2018**

Te arkëtueshme nga palët e lidhura

114,581,984

**Llogari të arkëtueshme tregtare**

**114,581,984**

“Të arkëtueshme nga palët e lidhura” në shumën 114,581,985 Lekë, konsiston në të ardhurat e realizuara nga shitjet ndaj Transcom WorldWide Italy S.P.A.

**9. SHPENZIME TË SHTYRA**

**31 dhjetor 2018**

Shpenzime të shtyra

1,286,701

**Total**

**1,286,701**

Shpenzimet e shtyra konsistojnë në policat e sigurimit dhe tarifa e licensës që skadon më 31/07/2019, pjesa që i takon vitit 2019 është njohur si shpenzim i shtyrë.

**10. TË ARKËTUESHME TË TJERA**

**31 dhjetor 2018**

TVSH e arkëtueshme

3,764,498

Të arkëtueshme të tjera

10,955

**Totali**

**3,775,453**

Gjatë vitit 2018 Shoqëria rezulton të ketë TVSH të arkëtueshme në vlerën 3,764,498 Lekë. Të arkëtueshme të tjera përfaqëson të drejtat e shoqërisë ndaj një punonjësi për shkak të rimbursimit të shpenzimeve të udhëtimit në një vlerë më të lartë se shpenzimi real.

**11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE E TË TJERA**

**31 dhjetor 2018**

Të pagueshme tregtare

7,895,453

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

2,839,505

**Totali**

**10,734,958**

“Të pagueshme ndaj palëve të lidhura” më 31 dhjetor 2018 lidhet me shërbimet që Shoqëria ka marrë gjatë vitit nga palë të lidhura, për të cilat ende nuk janë kryer pagesat.

“Të pagueshme tregtare” më 31 dhjetor 2018 lidhet kryesisht me shërbimet e konsulencës (kontabël dhe fiskale), shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, shërbimet e transportit, telefonisë dhe internetit.

Transcom Worldwide Albania sh.p.k  
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lekë)

**11.1. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
PricewaterhouseCoopers	2,619,618
Real Time	1,300,652
Flavia Softa	1,070,200
Sfera Informatica e Strumetazione	283,187
Airport Taxi	168,000
Karolina Rasa	59,689
Vodafone	29,686
Infosoft System	33,470
Xhinelda Hoxha	87,792
Abcom	11,356
Furnitorë të tjerë	2,231,804
<b>Totali</b>	<b>7,895,453</b>

Tek Furnitorë të tjerë është përfshirë vlera e detyrimit që ka shoqëria ndaj Portobello shpk, Megaies AL shpk, Ola 1 shpk, Mondo Compositi, Saimiri Muka, Arvi shpk, UKD.

**12. DETYRIME TË TJERA**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
Të pagueshme për paga	26,021,807
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	8,585,161
Tatim mbi të ardhurat personale	2,133,647
Shpenzime të përllogaritura	1,574,548
Tatim në burim	12,539
Të pagueshme të tjera	47,642
<b>Totali</b>	<b>38,375,344</b>

“Shpenzime të përllogaritura” lidhet me shërbimet e marra nga palët e lidhura, për të cilat nuk është kyer pagesa.

“Tatimi në burim” më 31 dhjetor 2018 lidhet me tatimin në burim të paguar të faturës së lëshuar nga Transcom Worldwide Vilnius për shërbimet e ofruara ndaj Shoqërisë.

“Të pagueshme të tjera” përfaqëson detyrimin që ka shoqëria ndaj punonjësve të saj për rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit.

**13. HUA**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
Huamarrje nga Transcom Worldwide Italy	117,249,000
Huamarrje nga Transcom Worldwide AB	12,342,000
<b>Totali</b>	<b>129,591,000</b>

Sipas Marrëveshjeve respektive që Transcom Worldwide Albania ka nënshkruar me Transcom Worldwide Italy dhe Transcom Worldwide AB, huaja është një formë financimi që këto të fundit i japin Shoqërisë në mënyrë që ajo të përmbushë detyrimet afatashkurtra të saj gjatë aktivitetit operativ me palë të treta.

Transcom Worldwide Albania sh.p.k  
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lekë)

**14. KAPITALI AKSIONAR**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
Kapitali aksionar	1,271,700
<b>Totali</b>	<b>1,271,700</b>

Aksionari i Shoqërisë është Transcom WorldWide AB i cili zotëron 100% të kuotave.

**15. SHPENZIMI I TATIM FITIMIT**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
Tatim fitim i pagueshëm	9,554,576
<b>Totali</b>	<b>9,554,576</b>

Tatim fitimi në Shqipëri është në masën 15% mbi fitimin e tatueshëm. Më poshtë është paraqitur rakordimi i tatimit mbi fitimin duke përdorur normën e aplikueshme të tatimit:

**16. NORMA TATIMORE EFEKTIVE**

	Norma efektive e tatimit	<b>31 dhjetor 2018</b>
Fitimi përpara tatimit		76,393,506
Norma e tatimit 15%	15%	11,789,696
Shpenzimet e pazbritshme	1%	1,125,505
Amortizim fiskal shtesë	-1%	(1,029,955)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin		<b>11,554,576</b>

**17. TË ARDHURA**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
Të ardhura nga shërbimi	315,752,417
<b>Totali</b>	<b>315,752,417</b>

“Të ardhura nga shërbimi” përfshin të ardhura e gjeneruara për shërbimet ndaj Transcom Worldwide Italy S.P.A.

**18. SHPENZIME PËR PERSONELIN**

Shpenzime page	178,171,386
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore	28,885,180
<b>Totali</b>	<b>207,056,566</b>



Transcom Worldwide Albania sh.p.k  
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lekë)

**19. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE**

	<b>31 dhjetor 2018</b>
Qira zyre	9,795,456
Shpenzime administrative	8,093,881
Shërbime profesionale dhe konsulence	3,265,661
Kosto te ri-faturueshme	1,636,787
Tarifa bankare	879,435
Shpenzime telekomunikimi	854,487
Shpenzime transporti	799,864
Shpenzime sigurimi	586,699
Liçensë	470,925
Shpenzime kancelarie	170,190
Taksa të tjera dhe shpenzime doganore	36,193
Shpenzime të tjera	<u>2,213,917</u>
<b>Totali</b>	<b>28,803,496</b>

**20. PALËT E LIDHURA**

Pala përfundimtare kontrolluese e Transcom WorldWide Albania është Transcom WorldWide AB.

Përmbledhje e gjendjes dhe transaksioneve me palët e lidhura është paraqitur si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2018</b>
<b>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</b>	
Transcom Worldwide Vilnius	312,919
Transcom Worldwide AB	72,910
Transcom Rostock GmbH DE5	249,210
Transcom Worldwide Italy	<u>2,204,466</u>
<b>Totali</b>	<b>2,839,505</b>
<b>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</b>	
Transcom WorldWide Italy	<u>114,581,984</u>
<b>Totali</b>	<b>114,581,984</b>

Asnjë nga balancat me palët e lidhura nuk është e siguruar dhe asnjë shpenzim nuk është bërë i njohur në vitin aktual për borxhet e këqija ose të dyshimta në lidhje me shumat që detyrohen nga palët e lidhura. Asnjë garanci nuk është dhënë ose është marrë.

**21. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së raportimit që kërkojnë rregullim ose pasqyrim në shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave financiare.